



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE
JASHTË

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. Q-21853/3 prot.

Tiranë, më 08/11 / 2021

Lënda: Kthim përgjigje

✓ Z. DORIAN MATLIJA

Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. Q-21853, datë 29.09.2021 dhe ka kaluar për shqyrtim te Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, e cila nëpërmjet Drejtorisë së Monitorimit të Taksës dhe Tarifave Vendore ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. prot. Q-21853/2, datë 04.11.2021 si vijon:

"Sipas informacionit të mbledhur nga Drejtoritë respektive të mbledhjes së të ardhurave planifikimit të investimeve dhe zbatimit të projekteve gjeni si më poshtë një pasqyrim të trajtimit të pyetjeve.

Sa është shuma e mbledhur nga taksa për infrastrukturën arsimore për periudhën 2016-2021?

Taksa e Përkohshme për Infrastrukturën Arsimore i nënshtrohet të gjitha familjeve, personave fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Detyrimi për Taksën e Përkohshme për Infrastrukturën Arsimore është vjetor.

Kjo taksë aplikohet për një periudhë 7 vjecare, që nga data e hyrjes në fuqi.

"Për kategorinë I "Familjarët" detyrimi paguhet në 12 këste të barabarta, për çdo muaj përkatësisht në shumën 150 lekë për çdo familje. Ky detyrim do të evidentohet në faturën e konsumit të ujit. Likuidimi i kësaj pagese kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit.

Për kategoritë II "Biznesi" detyrimi paguhet brenda datës 20 Prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtaz detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKB.

Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar taksën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal).

Realizimi në total i të ardhurave për Taksën e përkohshme për infrastrukturën arsimore për vitet 2016-2021, është i paraqitur si më poshtë:

Taksa për infrastrukturë	Periudha 2016-2021					
	2016	2017	2018	2019	2020	2021 9 Muaj
Familjarët	141,429,000	266,244,300	286,498,987	274,551,161	288,293,159	240,137,050
Subjektet Tregtare	354,521,390	415,682,866	443,596,174	425,221,988	361,099,635	393,263,578
Totali	495,950,390	681,927,166	730,095,161	699,773,149	649,392,794	633,400,628

Sa prej kësaj shume është shpenzuar dhe sa prej kësaj shume është gjendje?

Bashkia e Tiranës edo vit me anë të buxhetit të miratuar nga ana e saj bën të mundur rikonstruksionin dhe/ose ndërtimin e shkollave/institucioneve sipas planifikimeve të bëra dhe nevojave imediate që mund të dalin. Në vitet që kjo taksë e përkohshme është efektive shpenzimet e parashikuara dhe ato faktike për vitet 2016-2021 janë të paraqitura më poshtë:

Shpenzimet kapitale për vitet 2016-2021 në lidhje me infrastrukturën arsimore

Viti	Shpenzimet kapitale plan	Shpenzimet kapitale fakt
2016	950,993,118	527,133,711
2017	1,028,998,425	456,445,132
2018	1,191,405,746	791,019,922
2019	1,538,752,820	1,268,911,903
2020	2,209,589,292	1,005,751,432
2021	4,273,390,237	1,036,705,315
Total	11,193,129,638	5,085,967,415

Siç mund të vihet re lehtësisht këto shpenzime për investime janë më të larta se të ardhurat e mbledhura nga taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore.

Sa shkolla, institucione arsimore janë ndërtuar/rikonstruktuar nga ky fond?

Kopje të listës së shkollave, institucioneve arsimore të ndërtuara/ rikonstruktura nga fondi i mbledhur nga taksa për infrastrukturën arsimore?

Gjeni më poshtë një listë të të gjitha objekteve shkollore të ndërtuara/rikonstruktura gjatë viteve 2016-2019 dhe një listë të atyre që janë përfunduar dhe janë në proces gjatë viteve 2020-2021 sipas informacionit të marrë nga drejtoria respektive.

Objektet arsimore të ndërtuara nga viti 2016-2019			
Nr	Objektet		Viti 2016
1	Rehabilitimi dhe Instalimi i Sistemit te Ngrohjes (kati i dyte) ne shkollen 9-vjecare "Emin Duraku"	Rehabilitim	2016
2	Rehabilitimi I Pjesshem dhe Instalimi I Sistemit Të Ngrohjes Në Shkollën E Mesme "SINAN TAJAJ"	Rehabilitim	2016
3	Rehabilitim I shkolles 9-vjecare "Fan Noli"	Rikonstruksion	2016
4	Rehabilitim I pjesshem dhe instalimi I sistemit te ngrohjes ne shkollen 9-vjecare "4 Deshmoret"	Rehabilitim	2016
5	Rikonstruksion I plote e shtese ambientesh ne Shkollen e mesme "Qemal Stafa"	Rikonstruksion	2016
6	Rehabilitim I pjesshem dhe instalimi I sistemit te ngrohjes ne shkollen 9-vjecare "I Maji"	Rehabilitim	2016
7	Rikonstruksion i plote i shkolles speciale "Luigj Gurakuqi"	Rikonstruksion	2017
8	Rikonstruksion i shkolles Koreografike	Rikonstruksion	2017
9	Rikonstruksion i nyjeve sanitare , Shkolla 9-vjecare e Kuqe	Rikonstruksion	2017
10	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare në zonën e ish Kombinatit Tekstil (faza e parë)	Ndërtim I ri	2017
11	Ndërtim i Shkolles se mesme ne rrugen "Hoxha Tahsin"	Ndërtim I ri	2017
12	Rikonstruksion i shkolles 9-vjeçare "Siri Kodra"	Rikonstruksion	2017
13	Rehabilitimi dhe instalimi i sistemit te ngrohjes ne shkollen 9-vjeçare "Vasil Shanto"	Rehabilitim	2017
	Objektet		Viti 2018
14	Ndërtim shtese ne shkollen 9-vjeçare "Isa Boletini"	Rikonstruksion	2018

15	Rikonstruksion i shkollën 9-vjecare "Dora D' Istria"	Rikonstruksion	2018
16	Rehabilitimi i pjesshem dhe instalimi i sistemit te ngrohjes ne shkollën 9-vjecare "Dhura Leka" dhe ndertimi i palestres"	Rehabilitim	2018
17	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare "Deshmoret e Lirise"	Rikonstruksion	2018
18	Ndertim palestres "Shkolla e Mesme e Bashkuar Farke"	Ndertim i ri	2018
19	Rikonstruksion i pjesshem i shkolles se mesme "Andon Zako Çajupi"	Rikonstruksion	2018
20	Ndertim i salles se Koncerteve prane Auditorit te Liceut Artistik Jordan Misja"	Ndertim i ri	2018
21	Ndertim i shkolles 9-vjecare Kosova, Tiranë"	Ndertim i ri	2018
22	Rikonstruksion dhe Instalim i sistemit te ngrohjes ne shkollën e mesme "Ismail Qemali"	Rikonstruksion	2018
23	Ndertim i Ri i shkolles 9-vjecare "Servete Maçi"	Ndertim i ri	2018
24	Rehabilitim dhe instalimi i sistemit të ngrohjes ne Shkollën 9-vjecare "Mihal Grameno"	Rehabilitim	2018
25	Rikonstruksion i shkolles "Gustav Majer"	Rikonstruksion	2018
26	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare "Konferenca E Pezes"	Rikonstruksion	2019
27	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare Sabaudin Gabrani i	Rikonstruksion	2019
28	Rikonstruksion i shkolles se mesme te bashkuar "Ymer Lala", Surrel"	Rikonstruksion	2019
29	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare "Ndroq"	Rikonstruksion	2019
30	"Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare "Ali Demi"	Rikonstruksion	2019
31	Rikonstruksion dhe Shtese anesore e Shkolles 9-vjecare "I Qershori"	Rikonstruksion	2019

Nr	Emërtimi i Objektit	Nj.A	Statusi Aktual
I.	Objekte Arsimore		
1	"Ndertimi i Shkolles 9-vjecare Mangull"	Petrele	Përfunduar
2	Ndertimi i Kopshtit, "Fikas".	Petrele	Përfunduar
3	Ndertimi i Shkolles 9-vjecare, Peze e Vogel	Peze	Përfunduar
4	Ndertimi i Shkolles 9-vjecare, "Hasan Vogli"	9	Përfunduar
5	Ndertimi i Shkolles 9-vjecare, "Murat Toptani"	5	Përfunduar
6	Ndertimi i Shkolles 9-vjecare, "Qazim Turdiu"	9	Drejt perfundimit
7	Ndertim i shkolles "Sami Frasheri"	9	Në proces
8	Ndertimi i Shkolles 9-vjecare, "17-Shkurti, Qesarakë e Vjeter"	Dajt	Në proces
9	"Ndertim Kopshti Gurre"	Petrele	Në proces
10	Ndertimi i Shkollës Cikli I Ulët "Pajan"	Peze	Në proces
11	"Ndertimi i shkolles Bedri Llagami - Vaqarr"	Vaqarr	Në proces
12	"Ndertimi i Shkolles ne rrugen "Besim Daja"	8	Në proces
13	"Ndertimi i shkolles 9-vjeçare "Dritas"	Zall Herr	Në proces

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Blerta Goxha